



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVO**  
**KOMUNA E DRAGASHIT**  
**DRAGASH MUNICIPALITY-OPŠTINA DRAGAŠ**



**Datë:** 15.12.2023  
**02 Nr.183/01-32859/23**

## **PROCESVERBAL**

### **Diskutimi Publik për Draft Planin e Punës të Ekipit për të Drejtat e Fëmijës**

**I mbajtur më 13.12.2023, e mërkurë, duke filluar nga ora 13:00**  
**VENDI: Salla e Asamblesë Komunale – Dragash**

Konsultimi publik për Draft Planin e Punës të Ekipit për të Drejtat e Fëmijës ka zgjatur një muaj, sipas kriterëve të përcaktuara ligjore. Njoftimi për nisjen e procesit të konsultimit publik dhe mbajtjen e diskutimit publik, si dhe publikimi i Draftit për konsultim publik, janë publikuar në uebfaqen zyrtare dhe në Facebook-un zyrtar të Komunës.

#### **Njoftimi në uebfaqen zyrtare:**

Shqip: <https://k.k.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2023/11/Njoftimettt-3.pdf>

Boshnjakisht: <https://k.k.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2023/11/Njoftimettt-4-1.pdf>

#### **Njoftimi në Facebook-un zyrtar:**

Shqip dhe Boshnjakisht:

[https://www.facebook.com/permalink.php?story\\_fbid=pfbid0BC6bFqg2rgPmTjd8CfzHTNcNcoPu5Lag8NpHN4or6k2MjeGY6gpGC7KcNb7Nrevjle&id=100066575766996](https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=pfbid0BC6bFqg2rgPmTjd8CfzHTNcNcoPu5Lag8NpHN4or6k2MjeGY6gpGC7KcNb7Nrevjle&id=100066575766996)

## **Draft Plani i publikuar në rubrikën për konsultime publike:**

Shqip (Narrativi): <https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2023/11/NARRATIVI-I-PLANIT-TE-PUNES-se-EDF-2023-2025.docx>

Shqip (Plani i Veprimit): <https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2023/11/Plani-i-Veprimit-Dragashi-2024-2026.docx>

Boshnjakisht (Narrativi): <https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2023/11/Bos-NARRATIVI-I-PLANIT-TE-PUNES-se-EDF-2023-2025.docx>

Boshnjakisht (Plani i Veprimit): <https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2023/11/Bos-Plani-i-Veprimit-Dragashi-2024-2026.docx>

Diskutimi publik ka filluar në ora 13:00. Hapjen e takimit e ka bërë kryetari i Komunës së Dragashit, **z.Bexhet Xheladini**, i cili ka qenë edhe kryetar i Grupit Punues për hartimin e Planit të EDF-së, duke falënderuar të gjithë akterët të cilët kanë marrë pjesë në hartimin e këtij dokumenti mjaft të rëndësishëm për Komunën tonë. Ai ka falënderuar Zyrën e UNICEF-it në Kosovë për mbështetjen e vazhdueshme që i ka bërë Komunës së Dragashit, duke përfshirë edhe ndihmën e dhënë për hartimin e Planit të Punës për EDF-në.

Prezantimin e Draft Planit, duke përfshirë Narrativin dhe Planin e Veprimit, e ka bërë z.Agon Baxhaku, koordinator i UNICEF-it për Dragash.

**Agon Baxhaku:** Përshendetje për të gjithë! Ju falënderoj që keni gjetur kohën për të marrë pjesë në këtë diskutim publik. Plani i Punës i EDF-së është një dokument shumë i rëndësishëm për Komunën tonë. Më herët nuk kemi pasur një dokument të tillë, i cili i integron të gjitha shërbimet dhe i ofron mundësitë të mbrojtjes dhe zbatimit të të drejtave të fëmijëve të Komunës së Dragashit. Ne si Grup Punues në kuadër të EDF-së, për hartimin e këtij dokumenti kemi mbajtur edhe punëtori, ku kemi kërkuar nga institucionet dhe punëtorët komunalë që të na ofrojnë të dhënat, si dhe të na tregojnë vështirësitë, problematikat, dhe mënyrën se si ata e shohin avancimin e të drejtave të fëmijëve. Plani është i fokusuar në disa pika, ku më kryesoret janë shëndetësia, mirëqenia sociale, arsimi, kultura, rinia dhe sporti. Këto janë shtyllat bazë ku do të fokusohet i gjithë programi.

**Qamil Kolloni, drejtor pwr Ekonomi, Financa dhe Zhvillim:** Ju përgëzoj për punën që keni bërë si Grup Punues për hartimin e këtij Draft Plani. Uroj që këto objektiva të rëndësishme të përfshira brenda këtij dokumenti të përmbushen plotësisht në bazë të planifikimeve, sepse do të avancojnë në

masë të madhe të drejtat e fëmijëve në Komunën tonë, si dhe do të mundësonin integrimin sa më të mirë tyre në jetën sociale, arsimore dhe kulturore.

**Liridona Misinaj, drejtoreshë e DKRS-së:** Përshëndetje për të gjithë! Ju dëshiroj suksese në realizimin e objektivave të këtij Plani. Ne si Drejtori do të jemi në mbështetjen tuaj dhe do të ofrojmë përkrahjen tonë për realizimin sa më të mirë të tij. Ju faleminderit!

**Zeni Krasniqi, Drejtor i DKA-së:** Edhe ne si Drejtori e Arsimit ju urojmë suksese në realizimin e këtij Plani dhe do të ofrojmë përkrahjen tonë të rezervë për të gjithë Ekipin për të Drejtat e Fëmijës të Komunës së Dragashit.

**Lindita Kozmaqi Piraj, zyrtare për Barazi Gjinore:** Përshëndetje për të gjithë! Më vjen mirë që është hartuar ky Plan. Shresoj se do të ekzistojë vullneti, gjithmonë me përkrahje të donatorëve, për ta realizuar dhe jetësuar këtë Plan, sepse jemi mësuar që planet e hartuara me na mbet në sirtar, pa i bërë të prekshme dhe të matshme objektivat dhe aktivitetet e tyre. Shumë suksese dhe jam e hapur për bashkëpunim. Besoj se edhe e keni buxhetuar, apo jo?

**Agon Baxhaku:** Po. Në buxhetim ka punuar kolegu im në UNICEF, që ka punuar në plane të veprimit me buxhetim në Zyrën për Qeverisje të Mirë, dhe besoj që buxhetimi gjendet në Plan dhe mundet shumë thjesht me u gjet. Gjithashtu, unë kur e kam prezantuar punën time në Ekip, ke qenë pjesëmarrëse, i kam përmend aktivitetet të gjitha, me kosto buxhetore. Sa i përket të gjithë koston buxhetore, i kanë qit ata, për shkak se kodet buxhetore ne i kemi në Plan, po nuk i kemi qit, se i kemi dokument të brendshëm. Kodet buxhetore që i ka Komuna gjenden shumë thjesht, edhe kategoritë edhe të gjitha, qysh me u buxhetue ky projekt. Vlerat referente janë marrë me ndryshimet që janë bërë për shkak të inflacionit, rritjes së çmimeve. Edhe forma e Planit të Veprimit është sipas standardeve që ka propozuar Zyra e Kryeministrit rreth hartimit të planeve komunale dhe qendrore.

Një arsye shtesë pse i është dhënë një rëndësi e veçantë hartimit të këtij Plani, është edhe fakti se do të jetë si një indikator për performancën komunale, e sidomos për çështjet që lidhen me grupet e cënueshme, si aftësia e kufizuar e kështu me radhë. Gjithashtu, në këtë drejtim me një grup punues jemi duke u angazhuar edhe në hartimin e një Plani komunal për personat me aftësi të kufizuara. Ne si Komunë qëndrojmë mirë në këtë drejtim, sa i përket hartimit të këtyre dokumenteve. Një tregues i mirë është edhe fakti se jemi si Komunë target e UNICEF-it, i cili do të na mbështesë në vazhdimësi. Plani shumë shpejt pritet me kaluar edhe në mekanizmat institucionalë, në KPF dhe Asamble Komunale për miratim. Shpresojmë në realizimin sa më të plotë të tij! Ju falënderoj për pjesëmarrjen tuaj në këtë diskutim publik!

**Diskutimi publik ka përfunduar në ora 14:00!**

**Linqet e lajmeve për mbajtjen e diskutimit publik, të publikuara në uebfaqen dhe Facebook-un zyrtar:**

**Në uebfaqe:**

Shqip: <https://kk.rks-gov.net/dragash/news/u-mbajt-diskutim-publik-per-draft-planin-e-punes-per-ekipin-per-te-drejtat-e-femijes-te-komunes-se-dragasbit/>

Boshnjakisht: <https://kk.rks-gov.net/dragash/sr/news/odrzana-javna-rasprava-o-nacrtu-plana-rada-tima-za-prava-deteta-opstine-dragas/>

**Në Facebook:**

Shqip:

[https://www.facebook.com/permalink.php?story\\_fbid=psfbid02mDxbAQDNw9iHG263xX8gWvqxzdfrghNt4z9FL1SbPiG1PVHTzempuHaSK6mMwW9l&id=100066575766996](https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=psfbid02mDxbAQDNw9iHG263xX8gWvqxzdfrghNt4z9FL1SbPiG1PVHTzempuHaSK6mMwW9l&id=100066575766996)

Boshnjakisht:

[https://www.facebook.com/permalink.php?story\\_fbid=psfbid0BC6bFqg2rgPmTjd8CfzHTNcNcoPu5Lag8NpHNAAor6k2MjeGY6gpGC7KcNb7Nrenjl&id=100066575766996](https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=psfbid0BC6bFqg2rgPmTjd8CfzHTNcNcoPu5Lag8NpHNAAor6k2MjeGY6gpGC7KcNb7Nrenjl&id=100066575766996)

**SHTOJCË:** *Lista e pjesëmarrësve në diskutim publik dhe fotografitë*



LISTA E PJESËMARRËSVE NË DISKUTIM PUBLIK  
PLANI I PUNËS I EKIPIT PËR TË DREJTAT E FËMIJËS

Datë: 13.12.2023

Vendi: Salla e Asamblesë

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Pozita	Nr. Telefonit	Nënshkrimi
1.	Bekdet Kleshchun	KRYETAR		
2.	Agon Baxhaku	UNICEF		
3.	Parendi Bexheta	T. NË PRANË		
4.	Urimozë Berisha	QPS - ZYR.		
5.	LIRIDITA PIKAJ	ZBGTJ		
6.	LIRIDONA MISINAJ	DREJTORESH		
7.	Ferit Krasniqi	Drejtor		
8.	Qamil Kollonci	Drejtor		
9.	Resul Fetahu	Nënkryetar		
10.	Kenim Sahiti	Z. Kancel		
11.	RASHID RUSHITI	PLUC		
12.	VETON HALILI	SHFETI KABINETIT		
13.	Kapllan Fetahu	ABD. H. Krysi		
14.	BEHAR SELMANI	ARSK		
15.	DIBRAN ALIU	Z. KADASTER		
16.	FARIS KULLONI	Z. për Informim		
17.	Faton Nopuri	Z.L. Drejtor		
18.	Shaban Skenderi	Z.A. për tjetër		
19.	Netai Canalari	Drejtor O.A.P.		
20.				
21.				
22.	REPUBLICA E KOSOVËS			
23.	REPUBLICA KOSOVA			
	Komuna e Dragashit			
	Opština Dragash			

01 Nr. Br. 183/01-22859/23  
13.12.2023  
Dragash - Dragash

